

## Universiteti i Elbasanit "Aleksandër Xhuvani", merr pjesë në Panairin Work & Study 2024, duke ndarë mundësi dhe rrugë të reja për maturantët e Elbasanit.

Universiteti i Elbasanit "Aleksandër Xhuvani", merr pjesë në Panairin Work & Study 2024, duke ndarë mundësi dhe rrugë të reja për maturantët e Elbasanit. Zyra e Këshillimit të Karrierës, personeli akademik dhe studentët, kanë ofruar informacion të rëndësishëm për programet e studimit, programet e shkëmbimeve ndërkombëtare EU, mundësitë e praktikave profesionale dhe hapësirat e dedikuara për zhvillimin e tyre akademik, profesional dhe kulturor. Gjithashtu, maturantët që kanë vizituar stendën e universitetit kanë pasur rastin të dëgjojnë nga përvojat e suksesshme të studentëve aktualë dhe të të diplomuarve.

Ky aktivitet u zhvillua në kuadër të këshillimit të karrierës, në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, IAL, Dhomën e Tregtisë Tiranë, ZVAP Elbasan dhe Bashkinë Elbasan.



